

## **Vendim nr. 187, datë 04.06.2026**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

|                   |          |
|-------------------|----------|
| Fiona Papajorgji, | Kryetare |
| Marjana Semini,   | Anëtare  |
| Asim Vokshi,      | Anëtar   |

në datën 04.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 15 (E) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** ERJON KASMI, përfaqësuar nga avokati Rezart Tërshana, me prokurë të posaçme.

**XHULIAN XHAFA, ANDUEL GJERGJI, ARIOL ZENUNI, DENADA BARDHI, EMION ORIZAJ, ERIS KURILA, ILIR SHKURTI, INDRIT TILA, KLEVIN MOLLA, SKERDI LLUPI**

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1423, datë 23.09.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 00-2025-1423, datë 23.09.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 15, 18, 30, 34, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 135, 141, 142, 148, shkronja “dh”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e

**Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të  
ndryshuar (Ligji Organik i Gjykatës).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Në datën 09.12.2021 Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) ka regjistruar procedimin penal nr. 300 në ngarkim të kërkuessve Erjon Kasmi dhe Xhulian Xhafa për kryerjen e veprave penale “Mashtrimi kompjuterik”, në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal dhe “Grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 143/b, paragrafi 2, 28, paragrafi 4, 333/a, paragrafi 1 dhe 334 të Kodit Penal (*KP*). Ndërsa kërkuessit e tjerë janë akuzuar për veprën penale “Grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuar nga neni 333/a, paragrafi 2, i *KP*-së. Sipas hetimeve, këta shtetas kanë përdorur platforma të ndryshme me qëllim mashtrimin *online* të shtetasve të ndryshëm.

2. Në datën 13.06.2023 Prokuroria e Posaçme ka vendosur ndarjen e procedimit penal nr. 300 të vitit 2021 në dy procedime penale më vete: procedimin penal nr. 300 të vitit 2021 në ngarkim të kërkuessve me akuzat respektive dhe procedimin penal nr. 300/1 të vitit 2021 në ngarkim të personave të tjerë të paidentifikuar, për kryerjen e të njëjtave vepra penale, për hetime të mëtejshme. Ndërsa në datën 15.06.2023 Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesën për dërgimin në gjyq të procedimit nr. 300/2021 në ngarkim të kërkuessve.

3. Në seancën paraprake të datës 31.10.2023 prokurori, me kërkesë të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) (gjyqtarit të seancës paraprake) ka saktësuar akuzën ndaj kërkuessve Erjon Kasmi dhe Xhulian Xhafa nga paragrafi i parë i nenit 143/b të *KP*-së në paragrafin e dytë të tij, për shkak të pranisë së rrethanës cilësuese të kryerjes së veprës penale “në dëm të disa personave”. Me vendimin e datës 14.11.2023 gjyqtari i seancës paraprake ka vendosur vijimin e gjykimit, ndërsa për kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, referuar parashikimeve të nenit 332/c dhe 332/dh, pika 1, të Kodit të Procedurës

Penale (KPP), ka vlerësuar se nuk konstatohej se kishte vend për kthimin e akteve prokurorit, me qëllim plotësimin e hetimeve, në raport edhe me kohëzgjatjen relativisht të gjatë të hetimeve paraprake, si dhe parimin e barrës së provës në procesin penal, e cila i takon organit të prokurorisë. Sipas këtij vendimi, provat plotësonin standardin e mjaftueshmërisë për të mbështetur kërkimin për dërgimin në gjyq të çështjes, si dhe nuk konstatohej prezenca e akteve absolutisht të pavlefshme në kuptim të nenit 128/a të KPP-së.

4. Me vendimin e ndërmjetëm të datës 16.01.2024, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur pranimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar, me arsyetimin se në aspektin procedural ajo është në përputhje me parashikimet e neneve 332/c, pika 3, 403, pika 1 dhe 405, pika 5, të KPP-së, veprat penale për të cilat akuzohen kërkuesit nuk përmbajnë ndalim për zbatimin e tij dhe nuk janë ngritur pretendime për vlefshmërinë e akteve ose përdorshmërinë e tyre, si dhe nuk është kërkuar marrja e provave të reja. Po kështu, ajo ka vlerësuar se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet.

5. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 43, datë 08.07.2024, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesve Erjon Kasmi dhe Xhulian Xhafa për veprat penale “Mashtrimi kompjuterik”, të kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, dhe “Grupi i strukturuar kriminal”, si dhe dënimin e tyre respektivisht 7 vjet e 4 muaj burgim dhe 6 vjet e 8 muaj burgim; deklarimin të pafajshëm të kërkuesve të tjerë për veprën penale “Grupi i strukturuar kriminal”, pasi nuk provohet se e kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, si dhe ka konstatuar shuarjen e masave të sigurimit personal për ta. Sipas kësaj gjykate, provohet se dy kërkuesit Erjon Kasmi dhe Xhulian Xhafa kanë kryer veprat penale nëpërmjet veprimtarisë së *call-center*-it, duke dëmtuar shtetas gjermanë, gjatë periudhës 2018-2021, nëpërmjet nxitjes së tyre për të bërë investime me qëllim marrjen në mënyrë të kundërligjshme të vlerave monetare të të dëmtuarve. Kërkuesi Erjon Kasmi ka qenë në rolin e organizatorit dhe drejtuesit të grupit, ndërsa kërkuesi tjetër Xhulian Xhafa ka qenë pjesëmarrës në rol ndihmës. Për sa u përket kërkuesve të tjerë, kjo gjykatë ka vlerësuar se për veprën penale “Grupi i strukturuar kriminal” nuk rezultojnë elemente që provojnë tej çdo dyshimi kryerjen prej tyre të veprimeve që karakterizojnë nga ana objektive figurën e kësaj vepre penale. Gjithashtu, gjykata ka vlerësuar se pavarësisht pretendimeve të kërkuesve se nuk kanë qenë folës të gjuhës gjermane, sipas prokurorisë, provohet veprimtaria në fushën e mashtimit financiar të shtrirë jo vetëm në Gjermani,

por edhe në vende të tjera dhe se ata janë folës të gjuhëve të tjera e si të tillë kontaktonin personat e dëmtuar. Sipas gjykatës, për disa kërkues nuk ka të dhëna që i lidhin me faktin penal dhe nuk rezultojnë që prokuroria të ketë të dhëna që dëshmojnë për zhvillimin e aktivitetit të mashtrimit kompjuterik në Spanjë dhe nëse ky fakt është objekt i procedimit penal të ndarë nr. 300/1, ata duhet të hetoheshin në kuadër të atij procedimi. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Prokuroria e Posaçme duke kërkuar ndryshimin e vendimit lidhur me masën e dënimit për kërkuesit Erjon Kasmi dhe Xhulian Xhafa, si dhe deklarimin fajtor të kërkuesve të tjerë. Po kështu, kanë paraqitur ankim Erjon Kasmi, Xhulian Xhafa dhe apel kundërshtues kërkuesit Anduel Gjergji, Ilir Shkurti dhe Indrit Tila.

6. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 14 (87-2025-144), datë 23.04.2025, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e akteve për gjykim një kolegji tjetër të së njëjtës gjykatë. Sipas asaj gjykate, vendimi i ankimuar është rrjedhojë e mosrespektimit të dispozitave procedurale që kanë të bëjnë me ritin e gjykimit, me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori dhe me paraqitjen e akuzave të reja, çka sjell si pasojë prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues, bazuar në nenin 428, pika 1, shkronja “ç”, të KPP-së. Sipas saj, këto çështje mund të ngrihen edhe kryesisht nga gjykata, pavarësisht shkaqeve të ankimit, si dhe nuk përbëjnë cenim të parimit *reformatio in peius*, i cili shtrihet vetëm për dënimin ose cilësimin juridik të veprës penale. Për më tepër, ankim kanë bërë të dyja palët. Gjithashtu, kjo gjykatë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka gabuar në pranimin e gjykimit të shkurtuar dhe në dhënien e vendimit të pafajësisë për disa nga kërkuesit, pasi çështja nuk mund të zgjidhej në gjendjen që ndodheshin aktet. Të pandehurit ishin hetuar jo vetëm për veprën penale të “Grupit të strukturuar kriminal”, por edhe për “Mashtrimi kompjuterik”, të kryer në kuadër të këtij grupi, ndërkohë që për këtë fakt penal prokuroria nuk kishte disponuar as me pushim, as me dërgim në gjyq. Sipas saj, hetimet për funksionimin e platformave mashtruese për viktimat në shtete të tjera, si Itali, Greqi, Spanjë ose Francë, vijonin në procedimin e ndarë nr. 300/1 të vitit 2023, ndonëse këto të dhëna ishin vendimtare për të përcaktuar ekzistencën e grupit, rolin dhe përgjegjësinë e secilit të pandehur. Për këtë arsye, ndarja e procedimit penal ka dëmtuar vërtetimin e plotë të fakteve. Gjykata ka theksuar gjithashtu se pavarësisht faktit se “Grupi i strukturuar kriminal” është vepër autonome, kur grupi ka filluar kryerjen e veprave konkrete për të cilat është

krijuar, hetimi i pjesëmarrjes në grup nuk mund të shkëputet nga hetimi i veprës bazë, në këtë rast mashtrimi kompjuterik. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar në mënyrë kontradiktore, pasi, nga njëra anë, ka pranuar se çështja mund të zgjidhej me aktet ekzistuese, ndërsa, nga ana tjetër, ka dhënë pafajësi pikërisht për shkak të mungesës së provave që priteshin nga hetimet e papërfunduara dhe letërporositë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs kërkuesit Xhulian Xhafa, Indrit Tila, Klevin Molla, Erjon Kasmi, Skerdi Llupi, Ilir Shkurti, Anduel Gjergji, Ariol Zenuni, Eris Kurila, Denada Bardhi, Emion Orizaj dhe Prokuroria e Posaçme, si dhe kundërrekurs Klevin Molla.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1423, datë 23.09.2025, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura, pasi nuk përmbajnë asnjë nga shkaqet që parashikon neni 432 i KPP-së. Sipas këtij kolegji, GJKKO-ja e Apelit ka zbatuar drejt nenin 428, pika 1, shkronja “ç”, të KPP-së, duke prishur vendimin e shkallës së parë për shkak të shkeljeve të rënda procedurale që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori, ritin e gjykimit dhe paraqitjen e akuzave të reja. Kolegji Penal ka vlerësuar se kërkuesit janë hetuar edhe për veprën penale “Mashtrimi kompjuterik” në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, por për këtë vepër prokuroria as nuk ka ngritur akuzë, as nuk ka kërkuar pushimin e procedimit, ndërsa hetimet për funksionimin e platformave mashtruese ndaj viktimave në shtete të tjera vijnë në procedimin e ndarë nr. 300/1 të vitit 2023. Sipas këtij kolegji, këto rrethana e bënin të pamundur zgjidhjen e çështjes “në gjendjen që janë aktet”, ndaj pranimi i gjykimit të shkurtuar nga gjykata e shkallës së parë ka qenë i gabuar dhe në kundërshtim me kërkesat e nenit 403 të KPP-së. Gjithashtu, Kolegji Penal ka vlerësuar se ndarja e procedimit penal ka cenuar jo vetëm vërtetimin e plotë të fakteve, por edhe parimin e sigurisë juridike, pasi të pandehurit mbeten në një situatë të paqartë lidhur me përgjegjësinë e tyre për veprën e mashtrimit kompjuterik. Sipas Kolegjit Penal, GJKKO-ja e Apelit ka vepruar brenda kompetencave të saj për të garantuar ligjshmërinë e procesit penal dhe një proces të rregullt ligjor, pa paragjykuar fajësinë ose pafajësinë e të pandehurve. Për pasojë, vendimi për prishjen e vendimit të shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues konsiderohet i drejtë dhe në përputhje me ligjin procedural penal.

8. Në datën 19.03.2026 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, ndërsa në datën 23.04.2026 kërkuesi Erjon Kasmi ka paraqitur jurisprudencë shtesë në mbështetje të argumenteve të paraqitura në ankim.

## II

### Pretendimet e kërkuessve

9. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar si vijon:

9.1. Vendimi i Gjykatës së Lartë duhet të pezullohet, pasi prodhon efekte të menjëhershme në procesin penal dhe vë në diskutim forcën detyruese të një vendimi të formës së prerë të seancës paraprake për pranimin e gjykimit të shkurtuar. Ekzekutimi i menjëhershëm do të sillte pasoja të pakthyeshme, pasi do të lejonte zhvillimin e një rigjykimi në cenim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe parimit të sigurisë juridike. Asnjë nga kërkuesit nuk është në paraburgim dhe seanca gjyqësore nuk është çelur akoma.

9.2. Vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar *të drejtën për proces të rregullt* në drejtim të:

9.2.1. *Parimit të sigurisë juridike* në drejtim të *res judicata*, pasi Gjykata e Lartë ka vënë në diskutim një vendim të formës së prerë të gjykatës së seancës paraprake për zhvillimin e procesit me ritin e gjykimit të shkurtuar, vendim i cili nuk është ankimuar nga asnjëra palë, si dhe efektet e tij kundrejt pretendimit për mundësinë e ngritjes së akuzave të reja në këtë lloj gjykimi. Gjykata e apelit nuk ka kompetencë lëndore të shqyrtojë vlefshmërinë e vendimit të gjykatës së seancës paraprake, të vërë në diskutim përmbajtjen e tij ose të vlerësojë se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Nëse gjykata e seancës paraprake konstaton se çështja nuk mund të zgjidhet me aktet në dispozicion, ajo e kthen çështjen për plotësim hetimesh. Gjykata e Lartë në një vendim tjetër të saj ka vlerësuar se vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake kur nuk ankimohet merr statusin e formës së prerë dhe në gjykimin e shkurtuar nuk mund të zgjerohet fakti penal ose rëndimi i pozitës të të pandehurit me akuza të reja. Diskrecioni i gjykatës së ankimit për të shqyrtuar çështje të ligjit kryesisht nuk mund të ndryshojë efektin e një vendimi që ka marrë formë të prerë.

9.2.2. *Parimit reformatio in peius*, pasi Gjykata e Lartë ka përkeqësuar pozitën procedurale të kërkuarit Erjon Kasmi në mungesë të ankimit nga organi i akuzës dhe tej shkaqeve të ankimit. Nisur nga fakti se vendimet e Gjykatës së Lartë janë të detyrueshme për gjykatën që rigjykon çështjen, kjo e fundit do të rëndojë pozitën e kërkuarve. Gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk janë shprehur për kërkesën e kërkuarit Erjon Kasmi se për të nuk ka ankim të prokurorit, pra nuk mund të urdhërohet rëndimi i pozitës së tij. Kjo për shkak se ankimi i prokurorit nuk i është njoftuar kërkuarit Erjon Kasmi ose mbrojtësve të tij dhe gjykata e apelit nuk është shprehur lidhur me këtë kërkesë të kërkuarit. Gjykata e apelit ka rënduar pozitën e kërkuarit duke urdhëruar ushtrimin e ndjekjes penale edhe për rrethanën e shkakut të pasojave të rënda materiale, në mungesë të ankimit të prokurorit dhe në tejkalim të kompetencave të saj. Po kështu, urdhërimi i gjykatës së apelit për rikthimin e çështjes për shkak se nuk është ushtruar ndjekja penale në përputhje me ligjin përbën interpretim arbitrar dhe në kundërshtim me nenin 428, pika 1, shkronja “ç”, të KPP-së.

9.2.3. *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka urdhëruar që gjykata e themelit të ushtrojë kompetenca që ligji procedural ia atribuon ekskluzivisht gjykatës së seancës paraprake. Kompetencat e kësaj të fundit nuk mund të krijohen ose të transferohen nëpërmjet interpretimit gjyqësor. Gjithashtu, kjo gjykatë ka rivlerësuar diskrecionin e organit të akuzës për të korrigjuar mënyrën sesi prokurori ka ushtruar ndjekjen penale.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimimin e kërkuarve

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik,

subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kolegji çmon se kërkuessit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi janë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, që do të thotë se ajo mund të kërkohe vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor, pasi individ i ka shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve (*shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se në rastin e vendimeve që kanë kthyer çështjen për rishqyrtim në një gjykatë më të ulët, përjashtimisht nga rregulli i parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kontrollit kushtetues mund t’i nënshtrohen edhe vendime të tjera me natyrë jo përfundimtare që jepen gjatë një procesi gjyqësor, për shkak të pasojave të drejtpërdrejta në të drejtën kushtetuese të individit dhe pamundësisë së riparimit të shkeljes së pretenduar gjatë procesit të themelit, pra në procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar në juridiksionin e zakonshëm (*shih vendimet nr. 38, datë 10.06.2025; nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin në shqyrtim Kolegji vëren se objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i Gjykatës së Lartë që ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit që ka kthyer çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, për shkak të mosrespektimit të dispozitave procedurale që lidhen me ritin e gjykimit, ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori

dhe me paraqitjen e akuzave të reja. Kërkuesit kanë pretenduar se kanë përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike, gjësë së gjykuar dhe atë të gjykatës së caktuar me ligj. Sipas tyre, gjykata e rigjyimit është e lidhur nga interpretimi dhe orientimet e dhëna nga Gjykata e Lartë, e cila ka urdhëruar që gjykata që shqyrton çështjen në themel të marrë funksionet e gjykatës së seancës paraprake.

14. Në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri legjitimimi, Kolegji evidenton se ndonëse Gjykata në jurisprudencën e saj ka pranuar, në raste përjashtimore, se edhe vendime me natyrë jo përfundimtare mund t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues kur ato sjellin pasoja të drejtpërdrejta dhe të pariparueshme mbi një të drejtë substanciale, në rastin konkret kërkuesit nuk kanë arritur të identifikojnë cenimin e një të drejte substanciale në mënyrë të tillë që shkelja e pretenduar të mos mund të riparohet gjatë vijimit të procesit gjyqësor. Për më tepër, në çështjen konkrete procesi penal vijon ende dhe nuk është dhënë një vendim përfundimtar për themelin e akuzave në ngarkim të kërkuesve.

15. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se për sa kohë gjykata e apelit ka urdhëruar kthimin e çështjes në gjendjen fillestare, kërkuesit kanë mundësi të kundërshtojnë çdo veprim procedural ose vendimmarrje që, sipas tyre, bie ndesh me efektet e vendimit të formës së prerë të gjyqtarit të seancës paraprake për zhvillimin e gjyqimit të shkurtuar, si dhe të parashtrojnë pretendime lidhur me kufijtë e lejueshëm të akuzës dhe ndalimin e rëndimit të pozitës së tyre procedurale në mungesë të ankimit të prokurorit. Po kështu, ata mund të kërkojnë nga gjykata që do të rigjykojë çështjen respektimin e kompetencave të përcaktuara nga ligji procedural penal për gjyqtarin e seancës paraprake dhe për organin e akuzës, si edhe të kundërshtojnë çdo interpretim ose veprim procedural që, sipas tyre, cenon parimin e gjykatës së caktuar me ligj. Në të njëjtën kohë, kërkuesit kanë mundësinë të paraqesin sërish kërkesë për zhvillimin e gjyqimit të shkurtuar dhe të kundërshtojnë në rrugët e zakonshme të ankimit çdo vendimmarrje që do të merret në këtë drejtim. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se në rastin konkret vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë, i cili ka lënë në fuqi kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, nuk përbën një vendim përfundimtar për themelin e çështjes në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Në këto kushte, kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohen Gjykatës.

16. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31, 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.